

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Ekonomik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>E Drejta dhe Etika Bankare</b>
<b>Niveli:</b>	<b>BA</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti II, Semestri IV</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>4</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Armand Krasniqi MSc. Diamanta Sojeva</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:armand.krasniqi@uni-pr.edu">armand.krasniqi@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:diamanta.sojeva@uni-pr.edu">diamanta.sojeva@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kursi “E Drejta dhe Etika Bankare” është konceptuar të studioje në thellësi aspektet e sinkronizimit të normave ligjore (sistemit juridik) me kodin etik për rregullimin e ushtrimin të veprimtarive biznesore bankare që i ndërmarrin institucionet bankare. Në këtë funksion, kursi në fjalë trajton përbërësit e të drejtës bankare, marrëdhëniet bankë - klient dhe detyrimin e realizimit të këtyre marrëdhënieve mbi baza etike. Në këtë kurs trajtohet marrëdhënia juridike të punëve dhe llogarive bankare, koncepti juridik i porosisë dhe përfaqësimit në marrëdhënien bankë-klient dhe konceptet etike bazë të përfshirë në sferën e transaksioneve bankare. Me tutje, nga këndi i përgjegjësive etike trajtohen edhe aspektet juridike të transfertës bankare dhe veçanërisht të transfertave kapitale dhe korrente ndërkufitare dhe procedurat dhe legjislacioni përkatës. Gjithashtu, studentët do të njihen edhe me kontratat që i aplikojnë bankat në marrëdhëniet me klientë.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Ofrimi i njohurive specifike për etikën dhe bashkëveprimin me tërësinë e normave ose standardeve të sjelljes që rregullojnë veprimtarinë bankare. Programi trajton dhe argumenton domosdoshmërinë e bashkë- ekzistimit të normave etike dhe normave juridike të cilat si tërësi juridike rregullojnë funksionin e bankës në kuadër të sistemit financiar shtetërorë, marrëdhëniet e subjekteve brenda bankare, marrëdhëniet juridike - biznesore të bankës me institucion tjera bankarë e financiare dhe marrëdhëniet e juridike - biznesore

	që banka ka më partnerë gjegjësisht subjekte të cilave nëpërmjet aranzhmanave dhe produkteve specifike.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fitimi i njohurive për rritjen e kompetencën së studentëve mbi njohuritë, sjelljet dhe zbatimin në praktikë normave juridike dhe etike bankare konform normave moderne etike dhe juridike;</li> <li>• Detyrimi i kryerjes së funksioneve menaxherale bankare mbi bazën e normave etike dhe juridike</li> <li>• Njohjen e funksionimit të sistemit bankar, rolin e bankave në biznes, subjektet juridike bankare, etj nga këndi i rregullave juridike</li> <li>• Kuptimin dhe njohja e funksionimit të sistemit juridik bankar,</li> <li>• kuptimi dhe llojet e bankave dhe mundësitë për regjistrimin dhe shuarje e tyre, aktet juridike të bankave, kontratat dhe llojet e kontratave bankare, punët juridike kontabël, etj</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiime,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz,provim final)	1	6	6
Projektet, prezantimet ,etj	1	5	5
<b>Totali</b>			<b>100</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Meqë bëhet fjalë për një program që më shumë është i hartuar në planin e informacioneve dhe burimve teorike puna do koncentrohet në leksione. Ndërkaq pjesa e ushtrimeve do të fokusohet në punë me grupe, punime kërkimore - hulumtuese		

	dhe pjesë të prezantimeve nga studentët të cilët do të jenë të detyrueshme në punë kërkimore në fushën etikës dhe të drejtës bankare ;
<b>Metoda e vlerësimit:</b>	
<b>Vlerësimi ne %</b> 91 – 100% = nota 10 81 – 90 % = nota 9 71 – 80% = nota 8 61 – 70% = nota 7 51 – 60% = nota 6 0 – 50% = nota 5	Vijimi i ligjëratave = 0% Punimi kërkimor = 0% Punimi seminarik = 10 % Testi i parë = 45% Testi i dytë = 45 % Pjesëmarrja ne ushtrime = 0 Puna grupore dhe rasti i studimit = 0
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>E Drejta Bankare, Bankat dhe E-Banking</b> Armand Krasniqi &amp; Edmond Beqiri &amp; Alma Shehu Lokaj CSARA Publishing 2017</li> <li><b>E drejta Biznesore</b> Dr. Armand Krasniqi, tekst universitar, Botues Kol. Duk. Viti 2014</li> <li><b>E drejta Biznesore Ndërkombëtare</b> Dr. Armand Krasniqi, tekst universitar, Botues Kol.Duk. Viti 2015</li> <li><b>E drejta bankare</b>, Ergys Misha Botimi i 3 - të Tiranë 2009</li> <li><b>Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut</b>, Prishtinë, 2006Dr, Mehdi Hetemi .</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Të gjitha tekstet që kanë në përmbajtjen e tyre elementet e të ligjit dhe etikës bankare</li> <li>☞ Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe.</li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Kuptimi dhe lënda e të drejtës bankare, - Burimet formale - juridike të së drejtës bankare (Kushtetuta, Ligjet, kontratat ndërko., Aktet nënligjore, terminologjia, etj).
<b>Java e dytë:</b>	Subjektet e të drejtës bankare, Kuptimi i detyrimeve të pagesave dhe të parave, Parimi i nominalizmit monetar, Klauzolat kontraktuale mbrojtëse.
<b>Java e tretë:</b>	Institucionet financiare ndërkombëtare, FMN, Grupacioni Banka Botërore Banka Ndërkombëtare për Barazime (BIS), Banka Qendrore Evropiane Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim.
<b>Java e katërt:</b>	Ndikimi i integritimeve evropiane në krijimin e të drejtës bankare, Direktivat e UE, Harmonizimi i bankingut vendor

	me rregullat e OBT - GATTS, ISO etj
<b>Java e pestë:</b>	Letrat me vlerë – Kambiali dhe punët kambialore
<b>Java e gjashtë:</b>	Çeku Letër premtimi
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Testi i parë</b>
<b>Java e tetë:</b>	Titujt financiar – Aksionet, Obligacionet, Bonot e thesarit
<b>Java e nëntë:</b>	Notat, Letrat tregtare (dëftesa), Derivatet financiare
<b>Java e dhjetë:</b>	Bankat, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Shoqëritë e sigurimeve ,
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Fondet investive, Bursat
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Punët bankare, Punët aktive, Punët pasive, Punët neutrale, Punët individuale parabankare
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Etika - roli i saj në punët bankare dhe Etika në punët kontraktuale bankare
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Bankat dhe bankingu etik
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Testi i dytë</b>

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- ☞ Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin, orarin dhe rregullat e caktuara nga fakulteti
- ☞ Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore
- ☞ Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.